



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë .E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 558/ 6 Prot.

Tiranë, më 27 / 09 /2019

V E N D I M

Nr. 89 , Datë 27 / 09 /2019

PËR
AUDITIMIN FINANCIAR TEMATIK TË USHTRUAR NË BASHKINË
KURBIN
(Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018)

Në auditimin e ushtruar në Bashkinë Kurbin, rezultuan devijime nga kuadri rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit janë materiale (por jo të përhapura), efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar për llogaritë vjetore të Bashkisë Kurbin. Fushat kryesore të cilat janë konstatuar anomali janë pasqyrat financiare dhe planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat e tarifat vendore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesit, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm (Drejtori i Auditit të Brendshëm shqyrtoi në emër të tij), në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me qëllim përmirësimin e gjendjes,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit në Bashkinë Kurbin sipas programit të auditimit nr. nr. 558/1 prot., datë 13.08.2019, për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018.

II. Të miratoj opinionin, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i kualifikuar mbi pasqyrat financiare.

Opinionin e dhënë mbi besueshmërinë e llogarive vjetore e mbështesim në konstatimet së bilancet, deklaratat e të ardhurave, deklaratat e mbajtjes së të ardhurave, banka, janë përfshirë në deklaratat financiare. Janë marrë evidenca të mjaftueshme që të mund të japim një opinion. Deklaratat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

*“Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 shprehim një **opinion të kualifikuar**¹ për llogaritë vjetore të Bashkisë Kurbin duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore”.*

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Kurbin, të vitit ushtrimor 2018, vlerat e paraqitura në postet e Formatit nr.1, Pasqyra e pozicionit financiar, Bilanci, krahasuar me vlerat e paraqitura në informacionet që jepen në formatet anekse si Format nr.2, Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra të ardhura e shpenzime, Format nr.3, Pasqyra e flukseve monetare (cash flow), Format nr.4, Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/Fondet neto, Format nr.5, Shënime shpjeguese për hartimin e pasqyrave financiare vjetore, Format nr.6, Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimet e financimit, Format nr.7/a, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), Format nr.7/b, Pasqyra gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), Format nr.8, Pasqyra statistikore dhe numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i auditimit ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2% (vlerën 15,801 mijë lekë për shpenzimet) për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Përshkrimi i çështjeve:

- Gjendja e llogarive: **210** “*Toka Troje Terrene*” për vlerën historike 8,652,463 lekë, **211** “*Pyje Plantacione*” për vlerën historike 9,414,833 lekë, **212** “*Ndërtesa e Konstruksione*” për vlerën neto 1,301,665,655 lekë, **213** “*Rrugë, Rrjete, Vepra Ujorë*” për vlerën neto 1,233,614,513 lekë, “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” për vlerën neto 20,264,954 lekë, nuk është verifikuar ndonjëherë inventarizim për ekzistencën fizike të tyre, në sasi plotësi dhe vërtetësi si dhe nga Drejtoria e Aseteve, nuk janë mbajtur regjistra për Aktivet e Qëndrueshme, të plotësuara sipas kërkesave ligjore.

- Në dy vitet e fundit, nuk është verifikuar me inventarizim gjendja e llogarisë **215** “*Mjete transport*”, ku sipas kontabilitetit, është e analizuar për 23 mjete transporti.

- Gjendja e debitorëve në fund të vitit 2018, llogaria “*Debitorë të ndryshëm*” është për vlerën kontabël 3,678,921 lekë. Lidhur me përmbajtjen e kësaj llogarie, Drejtoria e Financës, nuk disponon të dhëna, dokumente ligjore e kontabël mbi subjektet debitorë, vlerën e debisë si dhe përmbajtjen e saj, me pretendimin se kjo vlerë është e trashëguar nga ish komunat sot Njësi Administrative të Bashkisë Kurbin, në kuadër të implementimit të reformës administrative në vitin 2015.

- Mos kontabilizim dhe evidentim të borxhit tatimor për vlerën 113 milionë lekë dhe mos ndjekja e procedurave ligjore për arkëtimin e tij.

- Në fushën e të ardhurave, mos administrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje (ALUIZNI), në vlerën 28.5 milionë lekë.

¹ *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërrputshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet e tjera financiare.*

- Mos administrim dhe mos evidentim i taksës së tokës, pasi dokumentacioni ligjor vijon të mbetet në ish- komunat që sot janë NJA të Bashkisë Kurbin duke mos u marrë në administrim nga bashkia.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Kurbin.

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe këto çështje i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun, ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vërtetësinë e gjendjeve fizike dhe nga analiza mbi përmbajtjen dhe dokumentacionin e nevojshëm justifikues të llogarive të Aktiveve Afatgjatë materiale; llogaritë 210, 211, 212, 213, 214 dhe 215, u konstatua se:

Llogaria 210 “Toka Troje Terrene” për vlerën historike 8,652,463 lekë, është pa lëvizje gjatë vitit 2018, **llogaria 211** “Pyje Plantacione” për vlerën historike 9,414,833 lekë, pa lëvizje gjatë vitit 2018, **llogaria 212** “Ndërtesa e Konstruksione” për vlerën neto 1,301,665,655 lekë, është shtuar gjatë vitit 2018 për 157,511 lekë, **llogaria 213** “Rrugë, Rjete, Vepra Ujorë” për vlerën neto 1,233,614,513, shtuar gjatë vitit 2018 për 70,814,024 lekë dhe **llogaria 214** “Instalime teknike, makineri e paisje” për vlerën neto 20,264,954 lekë.

-Në kontabilitet, janë mbajtur të analizuarat vlerat sipas objekteve të investuara nga Bashkia Kurbin ose të analizuarat sipas objekteve dhe në vlerë për rastet kur ato janë marrë në kontabilitet nga bashkimi i pasqyrave financiare të ish komunave, sot njësi administrative të Bashkisë Kurbin.

-Drejtoria e Financës dhe Sektori i Aseteve nuk ka të dhëna nëse është kryer ndonjëherë inventarizimi fizik për Aktivet e paluajtshme llogaritë 210, 211, 212 dhe 213, përkatësisht për: pyje, troje kullota, plantacione, objekte ndërtimore etj. të pa luajtshme në kundërshtim me kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pika 74 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

-Nga Drejtoria e Aseteve nuk janë mbajtur regjistra për Aktivet e Qëndrueshme në kundërshtim me kërkesat e pikave 26, 27 dhe 30, Kap. III të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Nga auditim mbi regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme në Kadastrën Vendore në pronësi të Bashkisë Kurbin, nuk na u paraqitën të dhëna për regjistrimin në pronësi dhe rrjedhimisht nuk kanë marrë certifikatën e pronësisë, veprime në kundërshtim me kërkesat e neneve 9, 12, Kap. III dhe neni 23, pika 14, Kap. VII të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

-Nga auditimi mbi vërtetësinë dhe plotësinë e gjendjes fizike të vlerës debitorë të llogarisë 215 “Mjete transport”, u konstatua se për këtë llogari nuk është kryer inventarizimi mbi gjendjen fizike të mjeteve të transportit për vitin 2018 dhe as në vitin 2017.

Drejtoria e Financës, nuk disponon kartela inventarizimi për këto aktive, në të cilat duhet të firmoset nga personat që i kanë në përdorim si dhe nga komisioni i inventarizimit.

Vlera historike e kësaj llogarie në pasqyrat financiare është për shumën 84,577,431 lekë.

Për këto Aktive Drejtoria e Financës, disponon vetëm procesverbale të marrjes në dorëzim të mjeteve, të cilat janë përgatitur në periudhën Janar 2017.

Nga analiza kontabël e kësaj llogarie që disponon Drejtoria e Financës, konstatohet se është e analizuar për 23 mjete transporti përfshi mjete të tilla si autoveturë, rimorkiatorë, manovrator, ekskavator etj.

Mos inventarizimit i këtyre aktiveve, krijon mundësinë për përdorimin abuziv të tyre dhe nuk i jep informacion drejtimit për njohjen e situatës së aktiveve.

Mos kryerja e inventarizimit të mjeteve të transportit për verifikimin e llogarive kontabël të pasqyrave financiare, është shkelje e kërkesave të nenit 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, pika 74 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe pika 30, Kap. III të UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 23-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin, të marrë masat që me specialist të fushës, të verifikojë dhe saktësojë pronat të investuara prej saj ndër vite si dhe për ato që me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të saj dhe të rakordojë rezultatet e inventarizimit dhe llogaritë kontabël përkatëse.

Të merren masat e nevojshme për përpilimin e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme me të dhënat e nevojshme sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Të kryhet inventarizimi fizik i mjeteve të transportit sipas përmbajtjes të llogarisë 215 “Mjete transporti” dhe të merren masat e nevojshme për administrimin dhe përdorimin e tyre për qëllime publike sipas procedurave ligjore dhe transparent.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2019

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje dhe mbi bazë risku të transaksioneve financiare për pagesat, u konstatua se përgjithësisht bashkëngjitur urdhër shpenzimeve janë dokumentet justifikues. U konstatua se në 10 raste, çdo muaj nga Bashkia Kurbin janë paguar nëpërmjet bankës bonus qiraje për pronarët e banesave në të cilat janë strehuar të pastrehët, sipas miratimit me Vendime të Këshillit të Bashkisë.

Për këto pagesa janë lidhur kontrata qiramarrje midis pronarëve qiradhënës, qiramarrësit dhe Bashkisë Kurbin. Praktika e pagesave janë likuiduar me urdhër shpenzimet nr. 1830-1839 datë 5.11.2018, në 4 raste nga 12,000 lekë në muaj dhe në 6 raste nga 10,000 lekë në muaj.

U konstatua se për këto pagesa nuk është mbajtur tatim mbi të ardhurat në burim për përfituesit e shumave, por tatimi është paguar nga Bashkia e Kurbin, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Në këtë rast, vlera e tatimit mbi të ardhurat në masën 15% që është paguar nga Bashkia Kurbin, për vitin 2018 është në shumën 194,400 lekë dhe është shkelje e disiplinës financiare me efekt negativ për buxhetin e Bashkisë (Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 23-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa që gjatë kryerjes së pagesave për bonus qiraje të banesave, shpenzimet për tatimin mbi të ardhurat në burim, ti llogarisë dhe ti ndalë nga përfituesit e bonusit të qerasë dhe jo nga burimet financiare të Bashkisë Kurbin.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2018 nuk janë evidentuar detyrimet e angazhimit financiar për periudhat e ardhshme bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit dhe të kontratave për qira dhënie të aseteve.

Për nxjerrjen e pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk është bërë rakordimi me Degën e Thesarit lidhur me të dhënat e Sistemit Informatikë të Thesarit (SIFQ) mbi pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të bilancit, për pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në kundërshtim me kërkesat, pikat 38, 39 dhe 40, Kap. II dhe pika 34 e Kap. III të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” (Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 23-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, të marrë masat për regjistrimin kontabël të detyrimeve të angazhimit sipas kontratave të lidhura me subjekte sipërmarrëse përfshi kontratat për dhënie me qira të aseteve. Për të pasqyruar saktë treguesit financiarë të burimeve dhe detyrimeve financiarë, në fund të periudhave ushtrimore, të rakordohet me Degën e Thesarit lidhur me të dhënat e Sistemit Informatik të Thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2018, gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është për vlerën kontabël 20,387,547 lekë.

Kjo llogari është e analizuar sipas llojeve për 38 objekte për të cilat janë ngurtësuar shumat në lekë si garanci për punimet e kryera sipas kushteve të kontratës, subjektit në emër të të cilit është bërë ngurtësimi dhe afatit të përfundimit të garancisë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se për 18 objekte në shumën 10,139,209 lekë, ka përfunduar afati i ngurtësimit të fondeve sipas kushteve të kontratës, nga të cilat: në vitin 2015 për 5 objekte në shumën 525,792 lekë, në vitin 2016 për 4 objekte në shumën 1,022,461 lekë, në vitin 2017 për 7 objekte në shumën 5,320,294 lekë dhe në vitin 2018 për 2 objekte në shumën 3,270,662 lekë.

Bashkia Kurbin, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për c’ ngurtësimin e këtyre fondeve për vlerën e llogaritur për 10,139,209 lekë për rastet kur subjektet kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës dhe ti përdorë ato për interesin publik (Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 23-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Deri më 30 nëntor 2019

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e debitorëve në fund të vitit 2018, llogaria “Debitorë të ndryshëm” është për vlerën kontabël 3,678,921 lekë. Lidhur me përmbajtjen e kësaj llogarie,

Drejtorie e Financës nuk disponon të dhëna dokumentare për subjektet debitorë, vlerën e debisë si dhe përmbajtjen e debisë, me pretendimin se kjo vlerë është e trashëguar nga ish komunat sot Njësi Administrative të Bashkisë Kurbin, në kuadër të implementimit të reformës administrative në vitin 2015. Kjo llogari për këtë vlerë debitorë, është pasqyruar ndër vite në pasqyrat financiare të Bashkisë Kurbin, por të pa shoqëruara me dokumente kontabël e ligjore.

Mbajtja e kontabilitetit dhe përpilimi i Pasqyrave Financiare, të pa bazuar në dokumente justifikues kontabël, është shkëlqje e kërkesave të pika 6, Kap. II e **UMF nr. 8, datë 9.03.2018** “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. dhe **neni 6 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004** “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 23-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Bashkia Kurbin të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit duke administruar dokumentacionin e nevojshëm kontabël e ligjor të ish Komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë Kurbin. Mbi bazën e këtyre saktësimeve, të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë.

Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Deri më 31 dhjetor 2019

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive të detyrimeve kreditore u konstatua se në Pasqyrat Financiare, detyrimet kreditore; llogaritë **401-408** “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, janë në vlerën kontabël 40,994,860 lekë.

Kjo llogari, është e analizuar për 247 raste kreditorësh nga të cilët për 79 raste në shumën 17,132,196 lekë i përkasin detyrimeve të krijuara në periudhën e viteve 2014-2017 dhe diferenca për 174 raste të tjera për vlerën 23,862,664 lekë janë detyrime të lindura gjatë vitit 2018.

Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion si dhe transferimi i detyrimeve nga njëri vit buxhetor në tjetrin, janë një risk real për buxhetin aktual e të vitit të ardhshëm të njësisë vendore, pasi akumulojnë nevojën e shpenzimit të fondeve jo për investime e projekte të reja, por për ato që tashmë janë përfunduar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52, -Kryerja e shpenzimeve, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikën 101, Kap. II të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ligjin nr. 48/2014 date 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, date 19.03.2015, UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 10.01.2018, “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 – Detyrimet e prapambetura të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore (*Më hollësisht trajtuar në pikën B faqe 23-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandim: Bashkia Kurbin të analizojë gjendjen e detyrimeve kreditore dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore uljen e detyrimeve, duke programuar pagesën e tyre në buxhetin e vitit të ardhshëm. Nga Drejtoria e Buxhetit të marren masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave. Të merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave në vitin e mëparshëm buxhetor. Në vazhdimësi çdo faturë shpenzimesh të likuidohet brenda afateve ligjore (30 ditë), duke shmangur transferimin e detyrimeve nga njëri vit buxhetor në tjetrin dhe të mos merren angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion. Në zbatim të pikës 88 të udhëzimit plotësues nr. 02, datë 10.01.2018 të bëhet publikimi i të gjitha detyrimeve të prapambetura në faqen zyrtare të institucionit.

Deri më 31 dhjetor 2019

7. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2018 Drejtoria Ekonomike ka administruar në total 11 vendime gjyqësore në vlerën totale 25,493,813 lekë, nga të cilat 9 vendime në vlerën 8,309,198 lekë lidhen me largime të padrejta nga puna, ndërsa 2 vendime në vlerën 17,184,615 lekë lidhen me çështje të natyrës prishje prone dhe pagim interesash të

prapambetura. Në buxhetin e vitit 2018 efekti financiar si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore ka vlerën 6,893,857 lekë dhe përfaqëson shpenzimet e kryera për 8 vendime gjyqësore për largime të pa drejta nga puna në vlerën 6,136,441 lekë (vendime gjyqësore të dala gjatë periudhës 2016-2017), si dhe vlera 757,416 lekë dëmshpërblim për prishje objekti (vendim gjyqësor i dalë në vitin 2015). Nga vlera e mësipërme prej 25,493,813 lekë, në datën 31.12.2018 ka ngelur pa likuiduar vlera prej 17,267,589 lekë e cila do të jap efekte negative financiare gjatë vitit të ardhshëm buxhetor 2019.

Janë 20 raste në të cilat Bashkia Kurbin është paditur nga persona fizike ose juridikë, megjithëse çështjet kanë kaluar shkallën e dytë të gjykimit që është ajo e Gjykatës së Apelit, nga Drejtoria Ekonomike nuk janë kontabilizuar të gjitha vendimet gjyqësore si detyrim për tu paguar për vitin 2018, me pretendimin se nuk janë përcjellë në këtë drejtori në kohën e duhur, duke mos u pasqyruar në Pasqyrat Financiare të këtij viti situata reale.

Mos kontabilizimi i këtyre detyrimeve, është shkelje e kërkesave të neneve 32, 34, Kap. III të UMF nr. 8 datë 9.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Nga Bashkia e Kurbin, nuk janë marrë masat e nevojshme për të ulur detyrimet për Vendimet Gjyqësore të krijuara në viteve e kaluara, shkelje e kërkesave të pikave 62, 102, Kap. II të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” (Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 19-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të krijojë bazën e të dhënave për vendimet gjyqësore, duke përcaktuar në vlerë detyrimin real që njëzia vendore ka. Në të ardhmen të kontabilizohet menjëherë çdo vendim gjyqësor që vjen në institucion. Nga titullari vendimi gjyqësor të përcillet menjëherë njëkohësisht në Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari të nxirren përgjegjësitë administrative dhe akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, sipas kërkesave të pikës 62, të udhëzimit nr. 2, datë 06.02. 2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Menjëherë e në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, nuk ka mbajtur rakordimet me agjent tatimor, me përjashtim të informacionit mujor që dërgohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë për tatimin e thjeshtuar. Nuk janë bërë rakordimet me ZVRPP Kurbin, si për taksën e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e reja, ashtu edhe për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, veprime në mos përputhje me nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara”, të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pika 2, germa a, përcaktohet se: “97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë”, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Kurbin, të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me QKB-në, QKL-në, Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, ZVRPP-në, Drejtorinë e ALUIZNI-t, etj., për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitetet në territorin e saj. Të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji.

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Kurbin në bashkëpunim me ZVRPP Kurbin, të llogarisë dhe të derdhë për llogari të Bashkisë Kurbin, 97% të të gjithë taksave të paguara nga personat juridikë/ fizikë, për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, e cila vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

8.3. Rekomandimi: Bashkia Kurbin, të marrë masa për evidentimin e diferencave të përmbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së

plotë të taksave/tarifave të përmbledhura apo të shmangura, sipas përcaktimeve në nenin 117 të ligjit 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Deri më 31 dhjetor 2019

9. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me aplikimin dhe pagesën e taksës së tokës, u konstatua se dokumentacioni nuk ndodhet në Bashkinë Kurbin, por në njësitë administrative përkatëse, veprim në kundërshtim me VKM-në nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” dhe të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrit për Çështjet Vendore dhe Ministrit të Financave nr. 3237, datë 16.7.2015 “Për procedurat, afatet kohore, standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm, për riorganizimin administrativo-territorial”. Gjithashtu, u konstatua se në regjistrat e kontabilitetit nuk ka të pasqyruar vlerat e debitorëve për këtë taksë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, Dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare” dhe me UMF nr. 8, Dt. 09.03.2018 “Për Paraqitjen e Pasqyrave Financiare në NJQP” (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandim: Bashkia Kurbin, të marrë masa për grumbullimin e të gjithë dokumentacionit në arkivin qendror të njësisë vendore, në përputhje me VKM-në dhe Udhëzimin e mësipërm.

Të verifikojë gjendjen në kontabilitet dhe mënyrën e kontabilizimit të detyrimit në ngarkim të familjeve debitorë për taksën e tokës, për periudhën përpara vitit 2015 dhe të kërkojë sipas ligjit, arkëtimin e këtyre vlerave nga personat përkatës.

Deri më 31 dhjetor 2019

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se këshilli bashkiak me vendimin nr. 176, datë 28.12.2017 “Për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin dhe institucioneve në varësi për vitin 2018”, ka vendosur të transferojë 44 punonjës të Bashkisë Kurbin pranë Ujësjeles Kanalizime Kurbin Sh.A. Nga ana tjetër këshilli bashkiak me vendimin nr.178, datë 28.12.2017 “Për miratimin e numrit total të punonjësve të Bashkisë Kurbin dhe agjencive në varësi, si dhe buxhetit të vitit 2018, Bashkia Kurbin”, ka miratuar buxhet për pagat e 44 punonjësve të transferuar. Vlera e parashikuar si “Transferim te Ujësjeles Sh.A.” është 13,555,872 lekë, ndërsa vlera e shpenzuar në fakt nga buxheti i Bashkisë Kurbin për pagat e punonjësve të mësipërm për vitin 2018 është 12,051,958 lekë. Transferimi i punonjësve nga Bashkia Kurbin drejt Ujësjeles Kanalizime Sh.A. dhe njëkohësisht vazhdimi i mbulimit me pagë nga bashkia, janë veprime kontradiktore të pa mbështetura me bazë ligjore. Pas momentit të transferimit, për periudhën e ardhshme njësia që e transferon punonjësin nuk ka më detyrime ndaj tij. Të drejtat dhe detyrimet e njësisë vendore, si dhe të punonjësit, janë të lidhura vetëm me periudhën gjatë së cilës punonjësi ka qenë në marrëdhënie pune në njësinë vendore. Ujësjeles Kanalizime është shoqëri aksionere e cila funksionon në bazë të ligjit nr. 9901, date 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, e cila ka politikat e saj tregtare, si dhe planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit i shoqërisë dhe të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme. Kjo shoqëri, në kuptimin e të ardhurave dhe shpenzimeve është e ndarë nga njësia vendore. Transferimi i fondeve për pagesën e 44 punonjësve jo vetëm që merr në mënyrë të pa drejtë fonde të njësisë vendore, duke ndikuar negativisht në buxhetin e saj, por ndikon negativisht edhe në performancën e shoqërisë aksionere Ujësjeles Kanalizime Kurbin, duke e përmirësuar këtë performancë në mënyrë fiktive (për vlerën e transferuar), si dhe denatyrton pasqyrat financiare të saj etj. (*Më hollësisht trajtuar në pikën A faqe 19-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkia Kurbin të marrë masa që në të ardhmen të ndërpritet praktika e pagesës së 44 punonjësve të Ujësjeles Kanalizime Sh.A. Kurbin, nga buxheti i Bashkisë Kurbin. Për këtë më parë të njoftojë zyrtarisht shoqërinë aksionere Ujësjeles Kanalizime Kurbin, me qëllim që kjo e fundit të llogarisë pagesën e punonjësve të mësipërm

nga buxheti i vet. Midis dy institucioneve zgjidhja të realizohet pa krijuar probleme në pagesën e punonjësve. Buxheti i njësisë vendore me fonde të taksapaguesve të komunitetit si dhe grante qeveritare, nuk ka si destinacion mbulimin e shpenzimeve për paga të një shoqërie aksionere e cila ka detyrë të miremenaxhojë aktivitetin e saj, duke mbuluar jo vetëm shpenzimet për pagat e punonjësve të vet, por edhe të krijojë fitime për ti investuar në sektorin e ujësjellësit.

Deri në miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2020

B/II. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2018, në zërin “*Të drejta të arkëtushme nga të tretë*”, paraqitet në vlerën zero, duke mos pasqyruar në to detyrimet e borxhit për taksat e tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik dhe abonentët familjarë në vlerën **113,664,338 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Kurbin, konkretisht:

Nr.	Emërtesa	Vlera e detyrimit
1.	Taksa e Tokës	37,701,506
2.	Abonentët familjarë	20,419,118
3.	ALUIZNI	28,535,422
4.	Bizneset	27,008,292
	<i>Nga e cila:</i>	
	<i>Gjoha të vitit 2017</i>	411,536
	<i>Detyrim papaguar periudha 2011-2018</i>	24,793,513
	<i>Kamatëvonesë 0.06% në 365 lekë</i>	1,803,243

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 1 e nenit 3, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë, “Mbajtja e kontabilitetit”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”; Ligji nr. 33-2017, “Për shuarjen e detyrimeve tatimore”; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën C faqe 31-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Kurbin, të marrë masat për kontabilizimi e detyrimeve të papaguara të taksave/tarifave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë deri në fund të vitit 2018 për vlerën **113,664,338 lekë**, si dhe zbatimin e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore RSH”.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

e- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me 3 Njësitë Administrative, respektivisht: Milot, Mamurras dhe Fushë Kuqe, të evidentojë listat emërore të debitorëve në mënyrë elektronike dhe të printuar dhe në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore, të verifikojë detyrimet, kamatëvonesat dhe gjokat për subjektet debitorë për periudhën përpara vitit 2014, nëse këto detyrime janë prekur nga Ligji nr. 33/2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore”.

Brenda datës 31 dhjetor 2019

C. MASA DISIPLINORE

Për punonjësit znj. E. P. me detyrë drejtoresh ekonomike, znj. R. K. me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, z. A. B. me detyrë drejtor i planifikimit të të ardhurave Bashkia Kurbin, për disa të meta e mangësi të identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit aktual, nuk rekomandojmë masa disiplinore për arsye se: Bashkia Kurbin është audituar nga KLSH sipas programit të auditimit nr.1267/1, datë 21.11.2018 për periudhën 01.01.2016 – 31.12.2018 dhe në fund të procesit të auditimit ka dalë **Vendimi nr. 18, datë 26.07.2019 i Kryetarit të KLSH**, ku për punonjësit e mësipërm është rekomanduar masë disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”. Gjithashtu mangësitë e konstatuara në këtë auditim, nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative të konstatuara në auditimin e mëparshëm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

